



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 mars 2013
Nr. ref.:RK394/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI111/12

Parashtruesi

Mit'hat Lozhani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Panelit të Lirimit me Kusht,
MD/PLK No. 02/12, të 29 majit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues është Mit'hat Lozhani, aktualisht në vuajtje të dënimit në Burgun e Gjilanit.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Aktvendimi i Panelit të Ministrisë së Drejtësisë për Lirimin me Kusht, MD/PLK nr. 02/12, i 29 majit 2012.
3. Për më tepër, më 26 korrik 2012, parashtruesi u njoftua nga Gjykata Supreme e Kosovës se “Gjykata nuk ka kompetencë për të shqyrtuar kërkesën e tij, pasi Paneli për Lirimin me Kusht është organ i pavarur dhe vendimet e tij janë të plotfuqishme”.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi, nga Gjykata Kushtetuese, i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, MD/PLK nr. 02/12, i 29 majit 2012, me të cilin është hedhur poshtë kërkesa e parashtruesit për lirim me kusht.
5. Në kërkesën e tij, parashtruesi i ka propozuar Gjykatës Kushtetuese që të ndryshojë vendimin e Panelit për Lirim me Kusht, MD/PLK nr. 02/12, e 29 majit 2012, si dhe të miratojë kërkesën e tij për lirim me kusht.

Baza juridike

6. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet: 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit, si dhe në Rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

7. Më 5 nëntor 2012, parashtruesi dorëzoi Kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese.
8. Më 6 dhjetor 2012, Kryetari i Gjykatës emëroi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues, si dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 10 dhjetor 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Panelin për Lirim me Kusht për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.
10. Më 24 dhjetor 2012, Paneli i Lirimit me Kusht dërgoi përgjigje ndaj kërkesës së parashtruesit, bashkë me dokumentet e tjera përkitazi me rastin e parashtruesit.
11. Më 13 mars 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga parashtruesat e palëve dhe të dokumenteve të bashkëngjitura, mund të nxirren fakte si në vijim.
13. Më 26 janar 2004, me aktgjykim të Gjykatës së Qarkut në Pejë, parashtruesi u shpall fajtor për veprën penale të vrasjes, siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 1, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe u dënua me 11 vjet burgim, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim.
14. Ekzekutimi i vuajtjes së dënimit me burg nga parashtruesi filloi më 26 korrik 2003.

15. Pas kryerjes së gjysmës së dënimit, në bazë të nenit 80.2 të KPPK-së, parashtruesi dorëzoi kërkesën e tij të parë për lirim me kusht.
16. Kërkesa e parashtruesit u shqyrtua më 17 prill 2009, nga Paneli për Lirim me Kusht, i përbërë nga tre gjyqtarë, të cilët vendosën se kushtet e përcaktuara me nenin 80 të KPPK-së nuk ishin përmbushur për shkak të sjelljes së parashtruesit. Shqyrtimi i rastit të parashtruesit u caktua pas një viti.
17. Më 30 prill 2010, Paneli shqyrtoi kërkesën e re të parashtruesit dhe e hodhi poshtë atë, me arsyetimin se, edhe pse parashtruesi ka filluar të përmbahet nga sjellja negative, nga të dhënat e ekipit profesional të qendrës korrektuese, është konstatuar që nuk ka arritur të kuptojë pasojat e veprës penale.
18. Paneli për Lirim me Kusht, më vonë, hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për lirim me kusht. Kjo ndodhi më 7 qershor 2011.
19. Më 7 tetor 2011, Paneli për Lirim me Kusht edhe një herë shqyrtoi kërkesën e parashtruesit, duke vepruar *ex officio*, dhe e hodhi poshtë atë. Në atë vendim, Paneli pranoi se kishte bërë gabim teknik në vendimin e mëhershëm, të 7 qershorit 2011, duke argumentuar se parashtruesi kishte arritur të ikte nga burgu. Paneli caktoi shqyrtimin e ri pas tre muajsh.
20. Kërkesa e parashtruesit për lirim me kusht u mor parasysh prapë, më 21 shkurt 2012, dhe u hodh poshtë vijimisht. Paneli i sugjeroi parashtruesit që të bëjë përpjekje për pajtim dhe përmirësim të marrëdhënieve me familjen e viktimës.
21. Më 29 maj 2012, Paneli për Lirim me Kusht edhe një herë shqyrtoi kërkesën e parashtruesit, si dhe gjeti që kushtet për lirin e tij ende nuk ishin përmbushur, në bazë të sjelljes së parashtruesit, pasi ai kishte kërcënuar një zyrtar korrektues.

Pretendimet e parashtruesit

22. Argumenti kryesor i parashtruesit, në mbështetje të kërkesës së tij, ishte që Vendimi i 29 majit 2012, i nxjerrë nga Paneli i Lirimit me Kusht, ishte i bazuar në fakte të gabueshme, si dhe kështu ishte i jashtëligjshëm. Ai argumentonte se kushtet për lirim, të përcaktuara me nenin 80 të KPPK-së, si dhe me dispozitat përkatëse të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Nr. 03/02-191, ishin përmbushur, si dhe, kështu, Gjykata Kushtetuese do të duhej të ndryshonte vendimin e kontestuar të 29 majit 2012.

Përgjigja nga pala e interesuar

23. Në përgjigje ndaj kërkesës, Paneli i Lirimit me Kusht ofroi pasqyrën e hollësishme të të gjitha vendimeve dhe të dokumenteve, në bazë të të cilave ishin miratuar këto vendime.
24. Përfundimisht, u propozua nga Paneli që të hidhet poshtë kërkesa e parashtruesit si e pabazuar.

Ligji i zbatueshëm

25. Neni 80 i KPPK-së (i publikuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/25, më 6 korrik 2003) përcakton:

**“Lirimi me kusht
Neni 80**

(1) *Personi i dënuar mund të lirohet me kusht nëse ekziston baza e arsyeshme se ai nuk do të kryejë vepër të re penale. Kur merret vendimi për lirimin me kusht të personit të dënuar duhet të merret parasysh sjellja e tij gjatë mbajtjes së dënimit.*

(2) *Personi i dënuar, i cili e ka mbajtur gjysmën e dënimit me burgim, mund të lirohet me kusht dhe të lirohet nga burgu me kusht se ai nuk do të kryejë vepër tjetër penale para skadimit të dënimit.*

(3) *Personi i dënuar, i cili ka mbajtur një të tretën e dënimit me burgim, përjashtimisht mund të lirohet me kusht kur rrethanat e veçanta që lidhen me personin e dënuar tregojnë se ai nuk do të kryejë vepër të re penale.*

(4) *I dënuari, i cili ka mbajtur tri të katërtat e dënimit me burgim afatgjatë, mund të lirohet me kusht.*

(5) *Për lirimin me kusht vendos trupi gjyqësor i themeluar nga organi kompetent publik në fushën e çështjeve gjyqësore në pajtim me ligjin”.*

26. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (2010/03-L-191), i 22 korrikut 2010, deri në masën relevante, përcakton në nenet e tij 128 dhe 129 si në vijim:

“Neni 128

Lirimi me kusht

1. Personit të dënuar mund t’i lejohet lirimi me kusht në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës.

2. Personi i dënuar ka të drejtë t’i paraqesë kërkesë për librim me kusht panelit të themeluar në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës nëpërmjet institucionit korrektues në të cilin ai është duke e mbajtur dënimin.

3. Pas paraqitjes së kërkesës për librim me kusht, Drejtori i Institucionit Korrektues kërkon nga Shërbimi Sprovues që të vizitojë të dënuarin dhe të nënshkruajë marrëveshjen për mbikëqyrjen e tij pas librimit me kusht.

4. Drejtori i institucionit korrektues mund të paraqesë propozim për librimin me kusht.

5. Pas paraqitjes së kërkesës apo propozimit për librimin me kusht, drejtori i institucionit korrektues, panelit për librim me kusht menjëherë i dorëzon kopjen e dosjes personale të personit të dënuar dhe raportin mbi personin e dënuar të hartuar nga ekipi profesionist në institucionin korrektues me anë të shkresës përcjellëse të cilën e nënshkruan Drejtori i Institucionit Korrektues.

6. Nëse paneli për librim me kusht nuk ka të dhëna të mjaftueshme, mund të kërkojë nga institucioni korrektues të dhëna shtesë.

7. Raporti nga paragrafi 5. i këtij neni përfshin:

7.1. llojin e veprës penale të kryer nga personi i dënuar;

7.2. qëndrimin e personit të dënuar ndaj veprës penale, viktimës dhe familjes së viktimës;

7.3. ndonjë vepër penale të kryer më parë nga ai;

7.4. rrethanat e tij familjare dhe të kaluarën shoqërore;

7.5. gjendjen e tij fizike dhe psikologjike, duke përfshirë vlerësimin e rrezikshmërisë kurdo që konsiderohet e nevojshme nga një psikiatër apo psikolog;

7.6. sjelljen e tij në institucionin korrektues dhe suksesin e arritur në shmangien e faktorëve të veprës penale;

7.7. planet e tij pas librimit;

7.8. përkrahja që mund t’i ofrohet pas librimit dhe

7.9. ndonjë rrethanë që tregon se ai nuk do të kryejë vepër të re penale.

Neni 129

1. Paneli për lirim me kusht, i themeluar nga Ministri i Drejtësisë, përbëhet nga një gjyqtar dhe dy (2) gjyqtarë laikë, të cilët kanë njohuri dhe përvojë në psikologji, kriminologji, psikiatri, pedagogji, sociologji dhe shkenca të tjera shoqërore lidhur me lirin me kusht.

2. Paneli për lirim me kusht vendos për të gjitha kërkesat dhe propozimet për lirin me kusht”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Në fillim, Gjykata thekson se parashtruesi nuk bën ndonjë pohim për shkelje të Kushtetutës, vetëm një shkelje të pretenduar të zbatimit të drejtë të ligjit vendës.
28. Parashtruesi vetëm sa kërkon nga Gjykata të vlerësojë ligjshmërinë e refuzimit në diskrecion të kërkesës së tij për lirim me kusht nga pjesa e mbetur e dënimit të tij, edhe pse Paneli i Lirimit me Kusht ka dhënë arsyetime të gjera për refuzimin e tillë të kërkesës së parashtruesit.
29. Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese do të donte të përkujtonte që, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet faktike apo juridike (ligjshmëria), që pohohen të jenë bërë nga Paneli për Lirim me Kusht, përveç nëse dhe deri në masën që ato mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Konventë (kushtetutshmëria). Kështu, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet që merren.
30. Në përfundim, parashtruesi as nuk e ka ndërtuar rastin e tij mbi ndonjë shkelje të ndonjë të drejte të tij të garantuar me Kushtetutë, e as nuk ka dorëzuar prova *prima facie* për një shkelje të tillë (*Shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i ECHR-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005*).
31. Kjo Gjykatë nuk mund të shërbejë si interpretuese e zbatimit të duhur të ligjit vendas.
32. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36.1. (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton: “(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar”.
33. Kështu, i propozoj Kolegjit shqyrtues të nxjerr përfundimin se, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, si dhe në bazë të rregullit 36 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË palëve këtë vendim;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtare raportuese


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani